

## RELACION PËR PROJEKTLIGJIN

### **“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.03.1995 “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Projektligji i paraqitur ka si qëllim që të shtojë në kompetencën e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar veprat penale të parashikuara nga neni 328 dhe 328/b i Kodit Penal.

Si rrjedhojë e kësaj kompetence të shtuar hetimi i veprave penale të parashkuara nga neni 328 dhe 328/b i Kodit Penal do të kryhet nga Prokuroria e Posacmë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK.

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuara dhe SPAK janë institucionet e reja të ngritura nga reforma në drejtësi që ka kryer Kuvendi i Shqipërisë në vitet e fundit dhe magjistratët që përbëjnë këto institucione kanë kaluar me sukses procesin e vettingut. Të dy këto organe të sistemit të drejtësisë kanë pavarësi të plotë nga influencat dhe ndërhyrjet politike, gëzojnë profesionalizëm, gëzojnë pavarësinë financiare dhe mjetet e nevojshme dhe të duhura hetimore për të mundësuar hetimin dhe më pas gjykimin e krimit të korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv në fushën e zgjedhjeve. Për shkak të rëndësisë së këtyre veprave penale, pasojave që ato sjellin dhe problematikës së shfaqur prej tyre në zgjedhjet e fundit, e identifikuar si e tillë edhe nga raportet e OSCE/ODIHR, iniciativa ligjvënëse për të ngritur nivelin e hetimit penal dhe gjykimit të saj në SPAK dhe në Gjykatën e Posacmë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përbëjnë një veprim në drejtimin e duhur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Inicitorët vlerësojnë se me këtë ndryshim ligjor parandalimi dhe luftimi i veprës penale të korrupsionit aktiv dhe/ose korrupsionit pasiv në zgjedhje do të ngrihet në një stad të ri, i cili i përgjigjet edhe pritshmërvive të publikut shqiptar dhe partnerëve ndërkombëtarë për të pasur rezultate të prekshme dhe të shpejta për cilind oqë ndërhyn në fushën e zgjedhjeve.